

**DEKLARATË**  
**E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**LIDHUR ME NGJARJET E DITËVE TË FUNDIT NË KOSOVË**

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ndjek me vëmendje të plotë dhe shqetësim të thellë ngjarjet e dhunshme të ditëve të fundit në Kosovë, të cilat çuan në humbjen e jetës së dhjetëra qytetarëve, në lëndimin e qindra të tjerëve dhe djegie e dëme të tjera materiale, të cilat janë pasuri e Kosovës. Kuvendi vlerëson se kjo situatë duhet të kapërcehet sa më parë, në emër të paqes, stabilitetit dhe bashkëpunimit, në emër të interesave të sotëm dhe të së ardhmes euroatlantike të Kosovës dhe të rajonit tonë.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka besim se të gjithë qytetarët e Kosovës do të tregojnë durim, gjakftohtësi, vetëpërmbytje dhe respektim të të gjitha institucioneve të saj. Gjithashtu ai ka besim se Kuvendi, Presidenti dhe Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me UNMIK-un dhe KFOR-in, do të gjejnë shumë shpejt dhe do të venë para ligjit provokatorët, organizatorët dhe shkakhtarët e gjakderdhjes e të shkatërrimeve, kudo qofshin këta, brenda ose jashtë Kosovës, për të kthyer sa më parë në normalitet jetën në vend dhe vazhdimin e proceseve europianizuese dhe integruese në Kosovë. Në këtë kuadër, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vlerëson interesimin dhe kontributin konkret që po japin edhe zyrtarë të lartë të strukturave qendrore europiane dhe euroatlantike.

Njëherësh Kuvendi i Republikës së Shqipërisë shpreh besimin se edhe partitë politike kosovare dhe faktorët e tjerë shoqërisë, me ndikim në jetën e qytetarëve të Kosovës, do të dëshmojnë pjekurinë e tyre dhe ndjenjën e lartë të përgjegjësisë, për përballimin me mençuri dhe gjakftohtësi të situatës së rëndë, për rikthimin e të gjithëve në punën e përbashkët për demokratizim të mëtejshëm dhe zhvillim të gjithanshëm të Kosovës shumetnike.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë shpreh bindjen se edhe të gjithë faktorët politikë e shoqërorë, i gjithë opinioni publik i vendit tonë, do të mbajnë të njëjtin qëndrim, në interes të një Kosove euroatlantike, në interes të paqes dhe të stabilitetit në rajon.